

VENDIM
Nr. 52, datë 6.2.2019

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE
PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2019, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, si dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2019

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	3	MoFE	Përgatit dhe paraqet në KM Kalendarin e MSHP
Janar	9	KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Janar	14	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2020 - 2022
Janar	21	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2020 - 2022
Janar	28	DZHM/KM	Shqyrton prioritetet e politikave 2020-2022 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	13	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2020-2022, për fazën strategjike
Shkurt	20	KPS/KM	Shqyrton dhe miraton prioritetet e politikave 2020-2022 (me ndikim në tavanet buxhetore), si edhe tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2020-2022, për fazën strategjike
Shkurt	28	MoFE	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2020-2022
Mars - Prill	1 Mars -24 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	25 Prill-26 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2020-2022
Maj	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2 - 16 Maj	MoFE /DZHM	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	2 - 16 Maj	KM/DZHM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në projekt dokumentin e prioritetëve të politikave 2020-2022.
Maj	17 Maj - 28 Maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Maj	29-31 Maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA 2020-2022 me shoqërinë civile
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	5	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	7	KPS/KM	Miraton dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2020-2022 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	10 -17 Qershor	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA 2020-2022 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2020-2022.
Qershor	21	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA 2020-2022 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2020-2022, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	29	KPS/KM	Miraton dokumentin e PBA 2020-2022 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022
Korrik	8	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2020-2022
Korrik	9	MoFE	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në fazën teknike, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Korrik - Gusht	11 Korrik - 31 Gusht	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	2	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	3-13	MoFE/DZHM	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.
Shtator	3-13	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2020-2022.
Shtator	16-25	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Tetor	4-11	MoFE	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2020 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2020-2022 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	15	KPS/KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2020, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2020-2022.
Tetor	18	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2020-2022, të miratuar nga KM-ja.
Tetor	18	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2020.